



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:016671

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05617287

KPPP.nr.50/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbaremore të kreditorit NPN Andigroup SH.P.K., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Arbnora Zeqiri, avokate nga Prishtina, kundër debitorit Ndërtimtari SH.P.K., me seli në rr. "Sejdi Kryeziu" pn, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Skender Musa, avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbaremore P.nr.1374/18 të datës 24.05.2018, të Përmbaremit Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 24.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit Ndërtimtari SH.P.K., ANULOHET Urdhri Përmbaremore P.nr.1374/18 i datës 24.05.2018, i Përmbaremit Privat Eset Murati dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbaremi në këtë çështje përmbaremore.

A r s y e t i m

Përmbaremi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit NPN Andigroup SH.P.K., me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin përmbaremore P.nr.1374/18 të datës 24.05.2018, me të cilin ka lejuar përmbaremin në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 44-2016 të datës 17.12.2016; me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në afatin prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri, t'ia paguaj kreditorit borxhin në lartësi prej 11,000.00 €, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga dita e rënies në vonesë 01.01.2017 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaremore, nën kërcënimin e përmbaremit të dhunshëm, në të kundërtën të bëhet përmbaremi i mjeteve monetare në llogaritë bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçantë të përmbaremit privat, si dhe me regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e

sendeve të luajshme dhe të paluajshme dhe përmbushjen e kredisë së kreditorit nga shuma e fituar nga shitja e atyre sendeve.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbarimor, duke theksuar ndër të tjera se me kreditorin nuk kanë pasur marrëveshje për periudhën që përshkruhet në propozim, ndërsa fletëpagesa e cila i është dërguar përmes përmbaruesit, debitori asnjëherë nuk ka dërguar dhe nuk ka pranuar asnjë lloj obligimi, për shkak se kreditori nuk ka kryer shërbim ndaj debitorit për detyrimin e kërkuar me anë të propozimit për përmbarim. Më tutje ka shtuar se në rastin konkret debitori asnjëherë nuk i'a ka pranuar këtë borxh kreditorit dhe se kreditori nuk ka siguruar prova apo dëshmi se i ka kryer punimet për të cilat kërkon që të paguhet.

I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit si i bazuar dhe të anulohet urdhri për përmbarim.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke deklaruar se kreditori i ka realizuar punët siç janë të përshkruara në faturë e për të cilat kreditori ka paguar edhe TVSH-në, pasi që pagesa është dashur të realizohet nga debitori. Ndërsa rreth pretendimit të debitorit se asnjëherë nuk ka qenë i njoftuar për faturë me qëllim të realizimit të pagesës, ka theksuar se fatura i është dërguar në emailin zyrtar të debitorit, por që e njëjta nuk i është përgjigjur kreditorit për realizimin e pagesës për punët e kryera. Në lidhje me pretendimin e debitorit se është ndërprerë kontrata e lidhur në mes të Ministrisë dhe debitorit, në këtë rast kreditori nuk është i obliguar që të dijë shkaqet e ndërprerjes së kësaj kontrate. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi urdhri përmbarimor.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, lidhur me këtë çështje përmbarimore me Aktvendimin PPP.nr.682/2018 të datës 22.06.2020 e ka hedhur poshtë propozimin për përmbarim dhe ka anuluar Urdhrin Përmbarimor P.nr.1374/18 të datës 24.05.2018.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.82/23 të datës 29.12.2023 ka aprovuar si të themeltë ankesën e kreditorit, e ka prishur Aktvendimin PPP.nr.682/2018 të datës 22.06.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë -

Departamenti i Përgjithshëm dhe e ka kthyer lëndën në rigjykim dhe rivendosje në Gjykatën Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë.

Gjykata Komerciale, në rivendosje, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe vërejtjeve të dhëna sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Fatura Nr. 44-2016 e datës 17.12.2016, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - Fatura Nr. 44-2016 e datës 17.12.2016, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura e lartcekur është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin ose vulën e pranuesit - debitorit, si dhe nuk ka asnjë dëshmi se e njëjta faturë është pranuar nga debitori në çfarëdo forme. Andaj duke qenë së debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt këtë faturë, e njëjta nuk mund të shërbejë si dokument i besueshëm.

Gjykata po ashtu shqyrtoi pretendimin e kreditorit se fatura e lartcekur është pranuar përmes komunikimit me email, mirëpo gjeti se një pretendim i tillë është në tërësi i pa bazuar, për faktin se kreditori nuk ka arritur të dëshmojë me asnjë provë se ndërmjet palëve ndërgjyqëse është zhvilluar komunikimi elektronik, përkatësisht se debitori ka pranuar faturën e cila është objekt shqyrtimi në këtë çështje përmbarimore.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbarimi.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti mbi të cilën mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk mund të shërbej si dokument i besueshëm pasi që nuk ka tipare të përmbarueshmërisë.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.50/24, datë 24.04.2024

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.